THE DEVELOPMENT OF THE LITERATURE OF THE ARBANASI OF ZADAR (300TH ANNIVERSARY OF THE ARBANASI OF ZADAR, 1726–2026)

ZHVILLIMI I LETËRSISË SË ABËNESHËVE TË ZARËS (300 VJETORI I ARBËNESHËVE (1726-2026)

Isak SHEMA

Universiteti i Prishtinës

Abstract

Over the 300-year period (1726–2026) of the life and activities of the Arbanasi of Zadar—the Albanians of Zadar—in their new settlement of Arbanasi, on the Dalmatian coast, they have made extraordinary efforts, despite extremely difficult living conditions and limited opportunities for educational, cultural, and scientific advancement, to preserve their national identity, the Albanian language, their Gheg dialect, and their traditional culture, as well as to cultivate literary works of artistic value imbued with the spirit of Albanian national identity. Through their creative commitment to literature, they have produced and published literary works of great national and universal significance, thereby securing their place in the history of Albanian literature. In both material and spiritual culture, they have enriched the Albanian cultural mosaic with distinctive features shaped by their new living environment and artistic experience. As Eqrem Çabej wrote in his study *Albanian Settlements Outside the Homeland*, they "have brought honour to the homeland of their ancestors and to their new homeland."
Arbanasi writers, including Josip Vlladoviq Rela, Šime Dešpalj, Aleksandër Stipqeviq, and others, have created poetry, short stories, novels, plays, and other works devoted to the traditional culture of the Arbanasi, their history, social life, and liberation struggles. Rela and Dešpalj produced literary works in the Arbanasi vernacular, while the Illyrologist Aleksandër Stipqeviq published the monumental work *The Traditional Culture of the Arbanasi of Zadar*, along with other scholarly works.

Keywords: Arbanasi of Zadar; Josip Vlladoviq Rela; Šime Dešpalj; Aleksandër Stipqeviq; literature; Albanians; poetry; prose; drama; culture.

Abstrakt

Gjatë periudhës kohore 300 vjeçare (1726-2026) të jetës dhe të veprimtarisë së Arbëneshëve të Zarës-të Shqiptarëve të Zarës, në vendbanimin e ri të Bregdetit të Dalmacisë, në Arbënesh, në kushte shumë të vështira të jetës dhe të emancipimit arsimor, kulturor dhe shkencor, kanë bërë përpjekje të jashtëzakonshme, të ruajnë qenie e tyre kombëtare, gjuhën shqipe, të folmen gege, kulturën tradicionale dhe të kultivojnë vepra me vlerë artistike me tipare të frymës kombëtare shqiptare.

Me përkushtimin krijues në letërsi kanë krijuar dhe publikuar vepra letrare që kanë rëndësi të madhe kombëtare dhe universale, duke i përfshirë ato në Historinë e letërsisë shqipe. Në kulturën materiale dhe shpirtërore kanë pasuruar mozaikun kulturor shqiptar edhe me veçori të ambientit të ri jetësor dhe artistik, siç ka shkruar Çabej në punimin "Ngulimet shqiptare jashtë atdheut" , "i kanë lënë nder atdheut të të parëve të tyre dhe atdheut të tyre të ri". Shkrimtarët arbëneshë: Josip Vlladoviç Rela, Shime Deshpali, Aleksandër Stipqeviç, etj., kanë krijuar poezi, tregime, romane, drama dhe vepra të tjera kushtuar kulturës tradicionale të arbëneshëve, historisë, jetës sociale dhe luftës çlirimtare. Rela dhe Deshpali kanë krijuar vepra të mirëfillta letrare në të folmen arbëneshe, ndërsa ilirologu Aleksandër Stipqeviç ka botuar veprën monumentale "Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës" dhe vepra të tjera.

Fjalë çelës: Arbëneshët,: Rela, Deshpali, Stipqeviç letërsia, shqiptar, poezia, proza, drama, kultura.

I.

Studimet historike letrare dhe sidomos ato albanologjike në tërësi për Histori, Gjuhësi,, Arsim, Kulturë, Muzikologji, për Ilirët në tërësi, kushtuarArbëneshëve të Zarës, janë shkruar nga shumë autorë shqiptarë dhe të huaj. Shquhen shumë vepra vepra referimi enciklopedike

për historinë e popullit shqiptar. Në librin tim "Arbëneshët e Zarës- Shqiptarët e Zarës"[1] (Histori, Gjuhë, Arsim, Kulturë, Letërsi etj., duke u bazuan në studimet e deritashme albanologjike, në publikimet publicistike dhe në materialet arkivore, kamë ndriçuar aspekte të ndryshme të ekzistencës 300 vjeçare të Arbëneshëve.

Kam botuar shumë artikuj, studime dhe vepra të veçanta, midis tyre dhe monografi të rëndësishme për Historinë e letërsisë shqipe. Bibliografia[2] e punimeve dhe e veprave të botuara në gjuhën shqipe, kroatisht dhe në gjuhë të tjera përfshin shumë njësi si shtojcë e posaçme e këtij punimi.

Në këtë studim, për shkak të kohës së kufizuar, në shenjë nderimi dhe përkujtimi të përjetshëm tri figura të ndritura krijuesish, kam zgjedhur autorët, siç janë: Josip V. Rela, Shime Deshpali dhe Aleksandër Stipqeviçi. Dy të parët kanë krijuar vepra të mirëfillta.letrare në të folmen arbëneshe, ndërsa ilirologu Aleksandër Stipqeviç ka botuar vepra historike, midis të cilave shquhet libri "Ilirët" Botimi i veprën monumentale "Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës" është kurora studimore kushtuar trashëgimisë së kulturës tradicionale të arbëneshëve dhe të popullit shqiptar.

Në librin „Histori e shkurtë e letërsisë shqipe I, (Me studimet e mia për letërsinë e traditës)[3], kam përfshirë natyrshëm edhe letërsinë e arbëneshëve të Zarës. Në vëllimin e dytë, i cili është në proces të botimit, përmblidhen sudimet kushtuar letërsisë bashkëkohore. Edhe këtu bën pjesë letërsia artistike e shkrimtarëve ar bëneshë. Në fushën e studime dhe botimeve gjuhësore, fjalori i autorit Dr. Kruno Krstić[4] është botimi më i rëndësishë leksikografik.

Për gjuhën e arbëneshëve Akademik Idriz Ajeti ka botuar veprën gjuhësore "Istorijski razvitak gegijskog govora arbanasa kod Zadra". Kjo e folme i përket dialektit gegë dhe "... ka rrjedhë nga gjuha me të cilën është folur në atdheun e hershëm të arbëneshëve në Brisk, Shestan dhe Livari (fshatra rreth Liqenit të Shkodrës) në fillim të shekullit XVIII. Gjuha e arbëneshëve të Zarës është studiuar nga gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj. Për të folmen e arbëneshëve studimin e veçantë dhe fjalorin kroatisht-arbënisht ka botuar edhe a Dr.sc. Maximiljana Barançiq, Mehmet Latifi dhe të tjerë. Shumë autorë shqiptarë dhe të huaj, gjatë tre shekujve të kaluar kanë publikuar punime, artikuj dhe vepra të veçanta për historinë, arsimin, gjuhën, letërsinë, kulturën, religjionin. etj.. Në bibliografinë[5] e kompletuar, Stipqeviq, si edhe shumë autorë të tjerë, ka sistemuar punimet e botuara për Arbëneshët.

Në krahasim me studimet e mia të deritashme kushtuar shqiptarëve të Zarës, qasja studimore në këtë kumtesë përfshin posaçërisht, kujtimet e paharrueshme për vizitat e mia në Arbënesh, dhe në Zarë, në Zagreb etj. . dhe për hulumtimet e gjithanshme, që nga viti 1959. Komunikimi sidomos me shkrimtarët, duke shkruar për këto takime të përzemërta vite me radhë në Arbënsh , por edhe në Kosovë, Shqipëri , në viset e tjera shqiptare dhe në diasporën shqiptare, ka qenë i vazhdueshëm dhe frytdhënës për studimet albanologjike.

Frymëzimi krijues, për të shkruar për këta njerëz të mirë, të ditur dhe të dashur, ka qenë i mrekullueshëm. Mikpritja e tyre e ngrohtë, miqësore, shqiptare, në vatrat e tyre familjare, ku është dera e hapur në shtëpitë e vjetra dhe të reja, është përjetësuar në forma të ndryshme. Flisnim arbënisht, në të folmen dialektore me theks karakteristik dhe unik, , e nga një herë me ndërprerje- kroatisht, italisht dhe në ndonjë gjuhë tjetër, për histori të gëzuara dhe tragjike të arbëneshëve. Për jetën familjare, për doket dhe zakonet arbëreshe. Gostitje dhe përurimet gjatë mëngjesit, drekës, darkës, pijet, ushqimet, kuzhina arbëneshe, tavolinat e stolisua me lule të freskëta të kopshteve, pemët dhe rrushi plot ngjyra dhe të përgatitura me shije Hareja

[1] Shema, Isak. Arbëneshët e Zarës Shqiptarët e Tarës, Prishtinë, 2004
[2] Shema, Isak, Punime dhe vepra të botuara për Arbëneshët eZarës (Bibliografi)
[3] Shema, Isak. *Histori e shkurtër e letërsisë shqipe* I, (Me studimet e mia për letërsinë e traditës), Prishtinë, 2026
[4] Dr. Kruno Krstić, "Rječnik govora zadarskih arbanasa", Bashkësia Lokale e Arbëneshëve, Zarë, 1987.
[5] Aleksandar Stipčević Bibliografija radova o zadarskim Arbanasima, **https://dizbi.hazu.hr/d17b118n/main/g/3k/19c/g3k19cdo78jg.pdf**

arbëneshe-shqiptare gjatë netëve të vona plot gëzim. Këngët e vashave dhe të burrave të Arbëneshit: " Zogu i verës", "Këndon zogu , zog mullinja", "Unë e dua nanën", "Në katund jonë", "Birbyli" etj. Disa i incizoja, i merrja me vete dhe i dëgjoja përsëri dhe përsëri më vonë në Kosovë dhe shumë më vonë në Shqipëri. Shëtitje në katund, në sheshet dhe në rrugët, disa prej tyre me emra shqip: Rruga Gjergj Kastrioti Skënderbeu Trg Gospe Loretske (Sheshi i Zonjës Loreto) – Qendra shpirtërore e lagjes, ku ndodhet kisha famullitare e Shën Mërisë së Loretos, pajtores së Arbëneshit, Karma ulica / Šetalište Karma (Rruga / Shëtitorja Karma) – Shëtitorja e famshme bregdetare që përshkon lagjen e Arbëneshit, Ulica Fra Gjergja Fishte (Rruga At Gjergj Fishta) – Kushtuar françeskanit dhe shkrimtarit të njohur shqiptar. (Sheshi Mbretëresha Teutë) – Kushtuar mbretëreshës ilire., drejt bregdetit, për t'u ndalur gjithherë te Fantana bukuoshe e Arbënesheve. Një skulpturë të saj, dhurate nga Shime Deshpali, e kam në Prishtinë, në shtëpinë time. Bisedonim në kafene, në shesh te Kisha në qendër, vizitonim Kishën "Zonja Jonë". Një ditë tjetër në Meshën Solemne-/kroatisht por jo shqip. Më pëlqenin veshjet dhe vallet e bukuka arbëneshe. Edhe unë këndoja dhe vallëzoja. Më sillnin gëzim të madh këngët që këndonim arbënisht. Kallëzimet përrallat dhe rrëfimet, për jetën, për ngjarjet e ndryshme, anekdotat dhe fjalët e urta

Takimi me shkrimtarin Josipn Rela (1895-1966) Arbëneshin e afroi me mua edhe më shumë. Vizitat në shtëpinë e tij, biseda për kohën kur ai ishte mësues në Vuthaj, pastaj në shkollat e bregdetit dalmatin, për shkrimet e para letrare dhe shumë të tjera. Lexonim poezitë arbënisht dhe kroatisht. Më fliste për veprat dramatike, së pari për melodramën „Martesa", të cilën e kishte shkruar pas kthimit në Arbënesh, pas vitit 1945, kur Këshilli i Qytetit e ktheu në Zarë. Në „AutoBibligrafinë e ve Rela shkruan: „…shkroi në dialektin e vet arbënesh një dramë të lehtë dhe argëtuese. Përmbajtjen e mori nga jeta e vetë Shqiptarëve, në mënyrë të zgjojë dhe të trimnojë Arbëneshët e vet dhe kështu ti bindë për nji jetë dhe ardhmëni ma të hareshme e ma të lumtun…Drama u lexue në nji tubim të gjanë të qytetarëve, ku mbërrijti nji sukses jashtë zakonisht të madh. Ndërkaq drama nuk pretendonte me u botue.

Për historinë e shpërnguljes së Arbëneshëve,.ai kishte tekstin origjinal, ku ndriçonte arsyen dhe rrethanat e shpërnguljes. Jetëshkrimi i tij në, në tetë faqe „Biografija Vlladiviq Relje N. Josipa", dorëshkrim, Zadar, 17.VIII.1963. përmbledh gjenealogjinë e familjes, jetën, veprimtarinë si mësues dhe krijimtarinë letrare të tij. Kujtimi për Vicko Zmajviqin ndër arbëneshët e të gjithë brezave është gjithmonë i pranishëm Vizita në Shkollën Fillore, kur ishte drejtor, përsëri në sheshet e vogla të arbënehit, në Kollovare, në Bregdet, në Zarë në Gradska Llozha, në Teatrin e Zarës, Në Muzeun e Qytetit, në Universitetin e Zarës, Teatrin e Zarës (Peppo kishte qenë drejtor i Teatrit. Hulumtimet e mia ishin mjaft interesante në Arkivin e Zarës, të paraqitura në botimin Mësimimësimin e gjuhës shqipe[6] në Arbënesh. Në krijimtarinë e Josipit paraqiten shumë mirë, përveç të tjerash, prirja e tij krijuese përkushtimi për të zgjedhur temat dhe idetë letrare, kujdesi ndaj përdorimit të gjuhës me veçori specifike. Sprovat poetike të tij qysh në fillim janë interesante, një ngazëllim i autorit për të zgjuar ndjenjat kombëtare dhe dashurinë ndaj gjuhës dhe traditave patriotike. Këtë më mirë e ilustron krijimi i melodramës „Martesa" dhe pastaj leximi i saj para arbëneshëve. Josip Rela gjatë fazë së parë të krijimtarisë, megjithatë ende nuk ishte ende i afirmuar si shkrimtar. Në vitin 1952, me rastin e vizitës së studentëve shqiptarë të albanologjisë, të cilët studionin në Degën e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë së Universitetit të Beogradit. Me profesori Dr.Vojisllav Dançetoviq studentët gjatë vizitës në Arbënesh dhe në Zarë, takuan Josip Relën dhe mësuar se kishte krijuar melodramën „Martesa" dhe kështu e njohën si shkrimtar shqiptar të kësaj pjese të diasporës shqiptare. Kjo qe vendimtare për publikimin dhe afirmimin mbresëlënës të krijimtarisë së tij në gjuhën shqipe në Kosovë dhe për botimin e saj që nga viti 1952 në Revistën „Jata e re". Më vonë botohen poezitë dhe veprat e tjera dramatike.

[6] Shema, Isak. Mësimi i shqipes në Arbëneh të Zarës, Prishtinë, 2017

Drama „Nita“ e botuar në vitin 1954 dhe shfaqet për herë të parë po në atë vit në Pejë, më 1955 në Teatrin Popullor në Prishtinë dhe në vende të tjera. Në librin „Antologjia e letërsisë shqipe“ të Hasan Vokshit, Elhami Nimanit dhe Tajar Hatipit, të botuar nga Shtëpia Botuese „Mustafa Bakija“, Prishtinë 1954, në 4000 ekzemplarë, . Regjimi i atëhershëm në atë vit e ka ndaluar dha asgjësuar gjithë tirazhin. Aty, shkruan Rela „…asht bote nji recension dhe nji fragment nga „Martesa“ e Josip V. Relës si dhe vjersha „Zani i të birunit, kurse në“Kangët e idhta dhe krenare“ “-poezi e shqiptarëve të TSFJ , bahet fjalë për poezinë e Josip Vlladoviq Relës dhe iu përkthyen e botuen serbokroatisht vjershat „Kisha me dashtë dhe „Shka jam unë“.

Për botimin e veprave të Josip Relës kontribut të madh ka dhënë Esad Mekuli. Shkrimtari, Ramiz Kelmendi, ka mbledhë, përkthyer, pajisur me shënime dhe ka shkruar pasthënien e botimeve të veprave të plota të Relës. Arkivin e materialeve të Relës e ka dorëzuar në Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani”të Kosovës.

Josip Rela gjatë viteve '50, pas botimit të disa veprave të mëparshme, u njoh dhe lidhi miqësi me disa shkrimtarë dhe intelektualë të tjerë të Kosovës. Më parë është njohur me Ramiz Kelmendin, Vehap Shitën, Idriz Ajetin dhe me njerëz të tjerë. Takimi i Relës me shqiptarë nga vise të ndryshme etnike shqiptare, dhe sidomos me shkrimtarë të njohur, ka ndikuar në procesin kompleks të krijimtarisë. Bepo kishte dëshirë të madhe të vizitojë Kosovën. Në një letër dërguar Vehap Shitës, më 25 janar 1955, ka shkruar: "Shum vshtirësina ka për t'i kalue për t'u gjie unë atje: Dimni, vjetët e mi, largsia, të hollat, dhe tjerat". Po ashtu në një letër dërguar Grupit amator të Pejës, pas shfaqjes së "Nitës" para publikut në gjuhën e veprës origjinale, Rela, përveç të tjerash, ka shkruar: "Sa i përket asaj se nuk më keni ftue në premierën e "Nitës", mos u turpnoni aspak dhe të mos ju vijë keq fare, sepse unë e di shumë mirë se sa luftojnë për mjete financiare të gjitha teatrot e vendit, e posaçërisht ato amatore, e së këndejmi, natyrisht edhe juaji. Nga ana tjetër, mirrni parasysh edhe largësinë, stinën e vitit e veç asaj edhe moshën time bukur të shkuar, kështu që pa dyshim nuk do të kisha mundur t'ju plotësoj dëshirën edhe sikur të kishin qenë në ujëra të kënaqshme financiare. Konsideroj pra, si të më kishit ftuar, e unë ju shpreh mirënjohje të sinqerta për dëshirat".[7]

Vizita e parë e Josip Relës në Kosovë është realizuar në korrik të vitit 1955. Ai ishte i ftuar të marrë pjesë në tubimin e letrarëve të Kosovës, për të cilin në revistën "Jeta e re" është shkruar: "Me iniciativën e Kryesis së Këshillit Krahinor të Lidhjes socialiste të popullit punues për Kosovë e Metohi dhe të Redakcis së revistës letrare "Jeta e re" u mbajt në Prishtinë më 8 e 9 korrik të këtij vjeti, mbledhja e parë e punëtorëve dhe dashamirëve të letërsisë së pakicës kombëtare shqiptare të Jugosllavis". Josip Rela dhe Budimir Peroviqi, arbëneshë të Zarës, u njohën me Esad Mekulin, Hasan Mekulin, Petro Janurën dhe me shumë personalitete të jetës arsimore dhe kulturore të Kosovës". Me atë rast vizituan disa qytete, institucione shkollore dhe ambiente turistike të Kosovës. Përshtypja që pati shkrimtari Rela mbeti e paharrueshme dhe e frymëzoi të trajtojë tema të ndryshme, që lidhen me këto vise autoktone shqiptare. Si shkrimtar i afirmuar Rela tregoi interesim të posaçëm për rrjedhat e zhvillimit të letërsisë shqiptare, për publicistikën dhe për veprimtarinë e institucioneve të tjera arsimore dhe kulturore të Kosovës, të Maqedonisë etj. Rela pas kësaj vizite do ta konsiderojë veten si pjesëtar aktiv të kësaj letërsie.

Qëndrimi i fundit i Josip Relës u realizua me rastin e shënimit të 10-vjetorit të botimit të revistës "Jeta e re". Me atë rast ishte i ftuar edhe shkrimtari arbënesh dhe bashkëpunëtori i zellshëm i kësaj reviste letrare. Mbledhja solemne e redaksisë dhe e bashkëpunëtorëve është mbajtur më 9 tetor 1959. Referatin për punën 10-vjeçare të "Jetës së re" dhe për zhvillimin e letërsisë shqiptare, në klubin e intelektualëve në Prishtinë, e lexoi Esad Mekuli. Pas drekës intime në hotelin "Avalla", "në sallën e këshillit populluer të komunës, u mbajt nji takim i ri i redakcis dhe i bashkëpunëtorëve të "Jetës së re" me letrarët jugosllavë, mysafirë në këtë kremtim, në të cilin u zhvilluen biseda spontane në lidhje me problemet e ndryshme të krijimit letrar në përgjithësi". Në vazhdim të

[7] Ramiz Kelmendi, "Nga epistolari i Relës", "Rilindja", Prishtinë, 1970, 6.XI, f.13

programit të kremtimit të këtij përvjetori të rëndësishëm është organizuar mbrëmje letrare. Gjatë ditës së dytë shkrimtarët, pra edhe Josip Rela, "... vizituen përmendoret kulturo – historike të Prishtinës dhe të rrethit të saj, Muzeumin krahinuer si dhe disa objekte më të mëdha ekonomike". Një mbrëmje letrare është organizuar në Mitrovicë. Të pranishmit shikuan edhe një shfaqje në Teatrin Popullor Krahinor. Më 11 tetor është organizuar një shetitje nëpër Kosovë (Prizren, Gjakovë, Deçan, Pejë etj.). Kujtimet e paharrueshme nga vizita në Kosovë Rela i ka evokuar me kënaqësi gjatë bisedave me bashkëkohësit. Malli dhe dashuria për vendin dhe për njerëzit janë shprehur edhe në krijimtarinë letrare. Ai ka pasur dëshirë të madhe të vijë në Kosovë edhe ndonjëherë tjetër, por, siç ka shkruar Rela: "... nja mendohet, por tjetra ndodhet..."

Kritka letrare e ka vlerësuar lart veprën "Nita", duke shquar veçoritë ideoartistike të kësaj drame të realizuar artistikisht. Në studimet historike letrare dhe në vështrimet kritike për këtë vepër, por edhe për aspekte të tjera të krijimtarisë letrare të Relës, autorët, siç janë: Rexhep Qosja, Ramiz Kelmendi, Vehap Shita, Ali D. Jasiqi, Nasho Jorgaqi, Aleksandar Stipçeviqi, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Sami Çabej, Esad Mekuli, Hasan Mekuli,etj., kanë dhënë vlerësime mjaft interesante.

Rexhep Qosja në studimin kushtuar Josip Relës ka shfaqur mendimin vlerësues shumë afirmativ, duke shquar dramën "Nita" ndër veprat më të mira të dramaturgjisë shqiptare të

kohës. Në veprën "Shkrimtarë dhe periudha" ka shkruar: "E shikuar prej një lagësie të duhur historike – qoftë edhe në kontekstin e tërë dramaturgjisë shqipe – "Nita" e Relës mund të radhitet ndër dramat e suksesshme historike te ne deritani".

Kjo dramë shumë e dashur për publikun artdashës, "... dramë me temën historike të shpërnguljes së arbëneshëve nga shpatijet e Rumisë dhe nga brigjet e Liqenit të Shkodrës – ka shkruar Aleksandër Stipçeviqi, është vepra dramatike më e popullarizuar... Për të pohojnë se në kuptimin e plotë të fjalës ka trazuar ndjenjat kombëtare të shqiptarëve. Është luajtur në të gjitha qendrat e mëdha të ..., ndërsa përgatitet premiera edhe ne Shkup". Bibliografia e krijimtarisë së Relës është shumë intersante, sepse aty jepen informaa edhe për shkrimtarët shqiptarë të Kosovës , cilët dhanë kontribut të çmuar jo vetëm për publikimin e e veprave ,por edhe për zhvillimin e procesit krijues letrar të shkrimtarit arbënesh, por edhe për leximin, e tyre, për shfajen e veprave dramatike, për studimin letrar të opusit të verave të Josip Relës etj.

Motivi patriotik në lirikën e Josip Relës është trajtuar në shumë poezi të krijuara në faza të ndryshme, dhe veçanërisht pas kthimit midis bashkatdhetarëve, "... atëherë kur edhe filloi të shkruajë vjershë në dialekt t'Arbëneshëve të Zadrës". Poeti në përmbledhjet "Pika s'largut", "Vjersha", "Limbjet e mija" etj., që i ka lënë në dorëshkrim, në dy ciklet: "Rreth vendlindjes" dhe "Atdheu", përfshin më shumë poezi patriotike. Në kuadër të përmbledhjes poetike, të dërguar për botim më 1964, i ka ruajtur titujt e këtyre cikleve dhe kështu kanë mbetur edhe në përmbledhjen "Vjersha". Cikli i dytë "Atdheu" përmban edhe këto poezi atdhetare: "Fjala e kangës sime", "Përgjegje t' eshtnave", "Liris", "Tregimi i okupatorit" dhe "Qysh jam unë".

Në përmbledhjen "Dhimbjet e mija" poeti kishte zgjedhur për botim edhe më shumë poezi të këtij lloji, disa prej të cilave i kishte botuar më parë në shtypin dhe në periodikun shqiptar.

Në disa poezi të tjera të ciklit "Rreth vendlindjes", në të cilat trajtohen motive sociale ose motive të tjera, spikaten ide të theksuara patriotike. Poezitë e tilla, që shquhen me elemente të lirikës së atdhedashurisë, janë: "Nana birit në prehen", "Tata birit të ritun", "Tata bijës pesmdhet vjetsh", "Derës s'oborrit", "Kronit të fikun", "Bregu i Sokos" etj. Në disa poezi të tjera të përmbledhjes "Vjershë në dialekt t'Arbëneshit", në strofa ose në vargje të veçanta, janë gërshetuar segmente të poezisë patriotike. Me këtë përmbajtje dallohen poezitë: "Fjalë të nxeta", "Përgjegje t'vorreve", "Ndjenja e ime", "Nëse nuk beson", "Marshi i rinis", etj.

Lirika patriotike e Josip Relës ka veçori ideore dhe estetike të përbashkëta me poezinë shqiptare të këtij lloji, por edhe tipare të veçanta. Në aspektin tematik kjo poezi është e lidhur me vendlindjen.

Krijimet e para patriotike në të vërtetë paraqesin dashurinë ndaj vendit ku jetojnë arbëneshët. Lokaliteti Arbënesh në këto poezi fiton atribute të atdheut të dytë, krahas atdheut të parë, Shqipërisë. Ai dallohet nga vendbanimet e tjera dhe është unik. Aty arbëneshët, brez pas brezi, e kanë ruajtur dhe e kanë zhvilluar më tutje vetëdijen kombëtare. Gjatë historisë kjo oazë shqiptare ka rezistuar dhe ka qëndruar e pa epur në baticat dhe zbaticat e kohës, prandaj arbëneshët deri vonë e kanë ruajtur gjuhën shqipe, kulturën shqiptare, doket dhe zakonet e të parëve të tyre.

Rela, si edhe poetët e tjerë që kanë kultivuar poezinë patriotike, në lirikën e tij ka shfaqur ndjenjën e patriotizmit, bindjen se i përket një bashkësie etnike, pra kombit shqiptar. Njëkohësisht ka treguar krenarinë e vet dhe të bashkëvendësve se historikisht i përkasin një vendi, Shqipërisë, atdheut të përbashkët të të gjithë shqiptarëve. Bashkë me idenë patriotike poeti ka shprehur edhe kërkesën e natyrshme për realizimin e drejtësisë sociale, për respektimin e të drejtave kombëtare, të idealit humanist dhe veçanërisht të idealit kombëtar. Midhat Frashëri në veprën "Plagët tona", idealin kombëtar e vlerëson si faktor të rëndësishëm në rrugën e zhvillimit të kombit. "Një popull – ka shkruar Frashëri –nukë rron dot pa ideal, pa një shtytkë, pa një qëllim që e bën të ecënj, të punojë, të përpiqetë dhe të përparojë...

Tematika historike në veprën e Relës ka shtrirje më të madhe, sidomos në dramat "Nita" dhe "Vampiri". Në të parën trajtohet tema historike e shpërnguljes së arbëneshëve nga atdheu i parë në Arbënesh të Zarës. Në këtë dramë gërshetohen elemente të përmbajtjes historike me ato të jetës sociale – shoqërore. Përfshihen ngjarjet midis viteve 1726-1729 dhe më vonë. Në dramën tjetër "Vampiri", që është e papërfunduar, autori merret me ngjarjet e kohës së Ali Pashë Tepelenës. Ideja e Relës ishte të krijojë një dramë interesante, ku posaçërisht do të paraqitej jeta dhe veprimtaria e Ali Pashë Tepelenës dhe epoka e tij. Aspekte të tjera të jetës së arbëneshëve janë paraqitur në krijimet e tjera dramatike, siç janë: "Kungulli", "Martesa", "Fisi i mallkuom", "Dila", etj. Autori temat e trajtuara në këto vepra i ka marrë nga e kaluara, që nga viti 1880 e këndej, dhe është përpjekur të paraqesë ngjarje dhe pamje të jetës, ashtu siç kanë ndodhur ato në të vërtetë. Shquhet posaçërisht prirja realiste për ta rikonstruktuar në planin artistik, në rrjedhat kryesore, jetën e kaluar. Mjaft mirë janë dhënë oshilimet e jetës shpirtërore dhe familjare, dramat e jetës individuale dhe kolektive, mentaliteti dhe psikologjia e bashkëvendasve dhe e njerëzve të tjerë. Në dy vepra të tjera: "Zani i fëmiut" dhe "Ik, Jak, ik" trajtohet tema e Luftës së Dytë Botërore. Drama e dytë më parë e kishte titullin "Nana". Në këto vepra letrare autori paraqet atmosferën që ka dominuar gjatë atyre viteve të luftës në Arbënesh, por edhe më gjerë. Në dramën "Ik, Jak, ik" zgjerohet rrethi tematik, por edhe hapësira ku zhvillohen ngjarjet. Teksti dramatik përfshin aspekte të jetës dhe rrethanat ekzistuese në Kosovë, por edhe në viset e tjera.

Tematika aktuale e pasluftës është trajtuar me sukses në disa krijime dramatike të mëvonshme. Vepra "Në liri" shtjellon ngjarje të periudhës midis viteve 1948-1950. Ngjarjet zhvillohen në hapësirë më të gjerë: në ish Jugosllavi, në Bullgari, në Turqi dhe në vise të tjera. Në këto vepra gjithnjë është i pranishëm edhe arbëneshi, me vizionin e tij jetësor dhe me të gjitha tiparet me të cilat shquhet karakteri i tij. Kjo shtrirje tematike mjaft e madhe në veprën dramatike të Relës është kushtëzuar nga interesimi i vetë autorit, që të kultivojë llojet karakteristike të poezisë dramatike: dramën, melodramën, komedinë, etj. Më dendur Rela ka trajtuar temën historike, temën e luftës dhe temën e jetës aktuale të pasluftës. Megjithatë, ky shkrimtar ka krijuar edhe dramën psikologjike. Temat e trajtuara nuk janë të ngjajshme dhe nuk përsëriten.

Larmia tematike, si edhe veçoritë e tjera ideoestetike, krijimtarinë dramatike të Josip Relës e bëjnë mjaft tërheqëse për lexuesit dhe shikuesit. Rela është treguar mjeshtër i mirë i krijimit të veprës dramatike. Mjeshtëria e tij letrare vërehet në shumë aspekte: në aspektin e zgjedhjes së temave, të organizimit të subjektit të veprës letrare, në prirjen realiste të tipizimit të personazheve dhe të ambienteve letrare, në ngritjen e konflikteve letrare, në fushëm e kompozicionit etj. Dramat më të realizuara artistikisht, siç janë "Nita", "Fisi i mallkuom", "Ik, Jak, ik" etj., janë shumë të përshtatshme për t'u shfaqur në skenë. Posaçërisht i është kushtuar kujdes i madh përshtatshmërisë

së shfaqjes në skenë të këtyre veprave. Rela ka dhënë elemente të shumta të skenografisë, të kostumeve etj., si edhe sqarime të tjera plotësuese për përgatitjen e këtyre pjesëve dramatike për t'u shfaqur më mirë në skenat e teatrove. Që nga vitet '50 dramat e tij janë shfaqur në skenat e teatrove tona pa ndërprerje.

Prirja e këtij dramaturgu për humor, për t'i kondensuar ngjarjet e paraqitura, për të paraqitur mendimin e vet lidhur me çështjet e shtruara, organizimi i suksesshëm i dialogjeve, si dhe fryma e përgjithshme realiste, e pranishme në krijimet letrare, janë veçori të tjera ideoartistike të krijimtarisë së tij letrare.

Në një vepër të vetme letrare autori përfshin shumë fakte dhe të dhëna të tjera dhe të gjitha janë të lidhura mirë në tërësinë kompozicionale. Shkrimtari arrin të realizojë ecurinë kompozicionale në etapat kryesore: ekspozicioni (paraqitja, prologu), thurja, kulminacioni, peripecia dhe shthurja. Respektohen dhe në shumicën e rasteve gjejnë zbatimin e tyre njësitë themelore të veprimit, të vendit dhe të kohës. Në këtë aspekt Rela përfill shumicën e elementeve të dramës klasike realiste, por nuk ngurron të përdorë edhe ato elemente funksionale të llojeve dramatike moderne. Të veçojmë, bie fjala, tiparet e dramës psikologjike dhe ato të dramës së karaktereve.

Galeria e tërë e personazheve të veprave dramtike të Relës është tipizuar në mënyrë realiste. Nëpërmjet tipizimit realist të personazheve dhe të ambienteve letrare, është paraqitur drama e arbëneshëve të Zarës dhe e popullit shqiptar gjatë periudhave të ndryshme historike dhe veçanërisht në rrethana të jetës aktuale pas Luftës së Dytë Botërore. Personazhet janë imagjinuar ose janë marrë nga historia jonë kombëtare.

Ndër dramat me temën historike, më të realizuara artistikisht të Josip Relës, shquhet "Nita". Kjo vepër është vlerësuar lart dhe konsiderohet ndër krijimet më të mira artistike të këtij lloji në letërsinë e sotme shqiptare. Në këtë dramë katëraktëshe është trajtuar tema historike e shpërnguljes së arbëneshëve, në ato kushte të rënda historike dhe shoqërore të sundimit të egër feudal turk, gjatë viteve njëzet dhe tridhjetë të shekullit XVIII. Rreth kësaj teme historike Rela ka shkruar edhe një fejton me titullin "Arbëneshët e Zarës", ku është përpjekur të ndriçojë me vërtetësi shkaqet dhe pasojat e shpërnguljes dhe aspektet e tjera të jetës së kaluar të arbëneshëve në Dalmaci.

Ai ka shkruar: "S'ka dyshim se ata kanë ikur përnjimend nga atdheu i tyre. Kanë ikur nga votrat, fushat e veta, pronat e veta, kurse rrethanat i kanë shpurë në Zarë – pa vullnetin e tyre.

Pse kanë ikur? Ja disa shkaqe:

1) Vendlindja e tyre ka qenë njëfarë trekëndshi kufitar; në të vërtetë, veriu i Shqipërisë gjendej ndërmjet Turqisë, Malit të Zi, dhe Dalmacisë së Venedikut, madje pikërisht në anën e majtë të malit Rumia. Mali Rumia gjendet ndërmjet Deti Adriatik dhe Liqenit të Shkodrës. Edhe sot e kësaj dite atje gjenden, pranë Liqenit të Shkodrës, fshatrat Brisku, Shestani dhe Livari, nga të cilat kanë ikur arbëneshët. Vetë ky fakt, se kanë qenë në këtë trekëndësh kufitar, për atë kohë sillte pasiguri: sulmet dhe plaçkitjet nga njëra anë cytnin hakmarrjen e anës tjetër, qoftë edhe kundër popullsisë së pafajshme.

2) Vetë "haraçi" zyrtar turk ka qenë i rëndë dhe i padurueshëm. Mirëpo, "mileti" nuk mundte që, posë haraçit zyrtar, të mbrohej dhe nga kapadahitë turq: agallarët, bejlerët dhe pashallarët. Dihet për marrjen e vocrrakëve si jeniçerë, dhunimet dhe marrjen e vajzave për hareme, marrjen e krenëve më të mira të bagëtisë etj.

3) Perandoria turke luftonte asokohe me Persinë. Lufta nuk i shkonte mirë, ndaj mblodhi dhe mori njerëz për ushtri kudo, vetëm për të kënaqur nevojat në luftën kundër persianëve. S'do mend se këta njerëz janë marrë pa mëshirë dhe egërsisht.

4) Pikërisht në atë kohë përhapej sëmundja e rrezikshme, kolera, që vinte nga Lindja dhe i kanosej Perëndimit.

5) Pa pikë dyshimi, rolin e vet e ka lojtur edhe feja. Të gjithë këta arbëneshë kanë qenë të krishterë – katolikë, kështu që pos të gjitha halleve, po qe se jua mirrte mendja të evitojnë së paku ndonjërin nga ata, detyroheshin të ndërrojnë edhe fenë e vet, duke pranuar atë islame.

Për shkasin e drejtpërdrejtë, që i ka shtrënguar të ndahen nga votrat e tyre, t'i lënë të gjitha këto dhe të ikin, nuk dihet të thuash asgjë. Është e sigurtë, ndërkaq, se do të ketë ekzistuar ndonjë shkak i fuqishëm dhe i drejtpërdrejtë, i cili ka shtrënguar të marrin këtë hap më drastik, të lënë kulmet e veta dhe të ikin në drejtim të panjohur. Autori i këtyne rreshtave, në dramën e vet "Nita", e cila bën fjalë për këtë ikje të arbëneshëve, si shkas për largimin nga trojet e veta paraqet frikën nga hakmarrja e turqve, për shkak të vrasjes së shërbëtorëve të bejlerëve, të cilët, me kërkesën e beut, rrëmbejnë vashën Nita, të cilën e shpëtojnë djelmoshat, duke mbytur rrëmbyesit. Ky është rrëfim arbitrar i dramaturgut, por është afër mendsh se pikërisht ky i afrohet më së shumti së vërtetës së pamohueshme".[8]

Drama është krijuar në fillim të viteve pesëdhjetë dhe është botuar në vazhdime në katër numrat e revistës letrare "Jeta e re" të vitit 1954. Deri atëherë në Kosovë, përveç "Martesës" dhe "Kungullit" të Josip Relës, ishin botuar këto tekte dramatike: "Çarshafi" – vepër e Hasan Vokshit, "Bija e pengueme" e Tajar Hatipit, ndërsa në Shqipëri: "Prefekti", "Cani Hoxhë" dhe "Prefekti" të Besimi Levonjës, "Don Gjoni", "Halili dhe Hajria", dhe "Toka jonë" të Kolë Jakovës etj. Në krahasim me poezinë dhe me prozën, drama si krijimtari mjaft komplekse dhe e vështirë, në këtë fazë ka pasur zhvillim më të ngadalshëm dhe të kufizuar. Ekspozicioni i dramës është mjaft interesant dhe paraqitet me invencion të rrallë:

II.

Vepra Letra E Shime Deshpalit (1987-2017)

Jetëshkrimi i Shime Deshpalit, i shkrimtarit të shquar të Arbëneshit të Zarës , është mjaft interesant. Rrëfimi i tij për jetën e vet dhe për krijimtarinë e gjthanshme arsimore dhe kulturore, ashtu siç e ka paraqitur ai gjatë takimit tonë në vitin 1973 e përfshijmë në punim. Biografinë e këtij shkrimtari të dashur dhe të respektuar e kam shkruar atëherë në fletoren time të shënimeve dhe ruhet në si dorëshkrim në arkivin letrar. Teksti kushtuar poetit, prozatorit, kompozitorit, dirigjentit, mësuesit dhe artistit shqiptar, i cili dha kontribut të madh në kulturën arbëneshe të shekullit XX, nuk është botuar deri më sot, prandaj si version më i plotë para lexuesve paraqitet për herë të parë.

Lindi në Arbënesh më 16 shkurt të vitit 1897 . Emri i tij është Shime, ndërsa emri i shënuar në kishë është Simon. Ai ishte i vetmi djalë. Kishte katër motra: Marea, Mieoa, Luçia dhe Ana. Gjyshi ishte Toma, i përkiste një familjeje të pasur , ndërsa gjyshja e tij quhej Mara. Babai quhej Pali (Pavle) dhe ishte bujk, ndërsa e ama ishte Matija Petani, e bija e një fshatari të pasur. Familja Deshpali ishte patriarkale. Gjyshi e largoi babain e Shimes nga shtëpia pa pasuri. Fëmijërinë e kaloi në Arbënesh. Në moshën shtatë vjeçare ka shkuar në shkollën fillore. Shkolla ka zgjatur gjashtë vjet. Për mësimin e gjuhës shqipe Pashk bardhi ka shkruar :"Në vitin 1901 filloi të jepet mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e Arbëneshit. Së pari filluan në Shkollën Normale dhe në shkollën profesionale të ngjitur Normales. Në Normale jepej mësimi tri orë në javë... Në shkollën profesionale jepet mësimi i gjuhës shqipe katër orë në javë, dy orë në klasën e dytë dhe dy në të tretën. Numri i nxënësve sillet aproksimativisht nga gjashtëdhjetë deri në shtatëdhjetë. Me përjashtim të një numri të vogël, të gjithë të tjerët janë shqiptarë. Përparimi është i kënaqshëm...".

Në vazhdim ai konstaton se më 1903 filloi mësimi i shqipes në shkollat femërore nga tri orë në javë, "një orë në klasën e dytë dhe dy orë në të tretën". Në Arbënesh ekzistonte edhe shkolla fillore mashkullore me mësim në gjuhën italiane, por atje në fillim nuk mësohej gjuha shqipe.

[8] Josip Rela: Vepra II, Rilindja, Prishtinë, 1971, f.259–260.

"Lega Nazionale" synonte italianizimin e arbëneshëve. Në këtë kohë ishte hapur çerdhja për fëmijë prej tri deri gjashtë vjet. "Fëmijët frekventues të kësaj, ka shkruar Bardhi, ndëgjohen duke folur italisht nëpër rrugët e Arbëneshit, gjë që përpara themelimit të kësaj përveç shqipes".çerdhe nuk ndodhte kurrë, sepse shqiptarët e Arbëneshit nuk flasin kurrë midis tyre tjetër gjuhë çerdhe nuk ndodhte kurrë, sepse shqiptarët e Arbëneshit nuk flasin kurrë midis tyre tjetër gjuhë.

Kreu tri klasat e gjimnazit në Hrvatska Gimnazija. Pastaj vazhdoi mësimet në Shkollën Normale, në Preparandija. Në shkollë ka qenë bashkë me disa arbënesh, siç janë: Lubo Deshpali, Pjetër Duka, , Berisllav Gjergja (i biri i mësuesit, Pal Gjergja), Toni Bushkoliq, Josip Rela, Pal Deshpali, Budimir Peroviq, Stjepan Peroviq, Krsto Petani). Gjuhën shqipe e ka mësuar dy herë në javë në shkollë. Mësuesit e shqipes kanë qen[: Pashk Bardhi,, Shtjefen Gjeçovi, Gjergj Koleci, Anton Paluca, Kolë Rrota nga Shkodra, Pal Gjergja (arbënesh). Nuk e përfundoi shkollën sepse largohet si ateist. Kishte reaguar drejtori i shkollës. E la Normalen sepse nuk pat perspektivë për inkuadrim. U dallua talenti i tij për muzikë. Mësuesit e mësuan pa pagesë. Edhe veglat ia dhanë pa pagesë.

Në fillim të vitit 1915 , në janar, mobilizohet në ushtrinë austro hungareze bashkë me Andrija Mazija, ... Mateshiq, Bailo Toni, Josip Jelenkoviq, dhe arbënesh të tjerë. Disa prej tyre Qeveria austro hungareze i caktoi mësues në Mal të Zi: Josip Rela, Stevan Peroviq, (Pipe), Lubo Deshpal, Krsto Peroviq, Maroviq Toni e të tjerë. Prej Zarës janë dërguar në Mostar, pastaj në marsh batalon. Që nga mosha 18 vjeçare shquhet si dirigjen për orkestër dha ato frymore. Interesohet për kompozim.

Nga lufta është kthyer më 1918 në Erdel të Austro Hungarisë. Ai është kthyer në Zarë i sëmurë. Ka punuar si dirigjent në "Sokol" dhe në Kishën e Arbëneshit. Deri n kohën e pushtimit italian të Zarës në Hrvatska çitaonica (në ballë të Leximores Kroate të Arbëneshit ishte portereti i Skënderbeut. Më 1920 pas migrimit Shime ndahet nga prindërit, i vetmuar. Prindërit i vdesin në Arbënesh. I ati vdes nga torturat që i bëjnë italianët në Itali. E ama e varfër i vdes në Arbënesh. Po ashtu i vdesin edhe tri motra. Pas ardhjes së italianëve në Zarë, më 1920 emigroi në Jugosllavi, në Split. Arbëneshët ishin kundër pushtimit italian, prandaj shumë prej tyre kalojnë në territorin e Jugosllavisë. Disa arbënesh ishin të partitit kroat, ndërsa disa të tjerë proitalianë..Shime migroi në Hvar. Ka punuar si dirigjent i orkestrës dhe si instruktor i muzikës. Aty ka qëndruar afër pesë vjet. Me që nuk kishte rrogë, detyrohet të punojë si nëpunës në kadastër. Pastaj është transferuar në Pag, në Rab, në Bllato tč Korçullës. Aty në vitin 1934 i lind fëmija i parë, Pavli, ndërsa më 1942 vajza, Maja. Në Dubrovnik drejton orkestrën.

Lufta e Dytë Botërore e gjen në Korçulla. Në fillim të vitit 1943 ka qenë i angazhuar me punë në terren për të organizuar mobilizimin e tij, ka qenë i ftuar në ushtrinë partizane. Në qarkun e Dubrovnikut ka qenë dirigjent i orkestrës, përgjegjës për shkolla të muzikës. Ka qenë përgjegjës për arsim dhe kulturë, ka organizuar korin, teatrin etj.

Pas kthimit në Zarë është angazhuar si intendant për themelimin e Teatrit të Zarës. Ka qenë dirigjent i orkestrës. Në Zarë ka qenë mësues i muzikës, drejtor i Shkollës së Muzikës.Akademik Pavle Deshpali, i biri i Shimes, ka shkruar: Moj otac Šime Dešpalj postavio je Hrvatsko narodno kazalište, uz veliku pomoć prof. Šime Dunatova. Obnovio je Zadarsku filharmoniju, koju su naslijedili maestro Štajcer i kasnije prof. Jerolimov. Osnivao je Muzičku školu s kojom je surađivao do smrti. Predavao je generacijama muzički odgoj na gimnaziji i učiteljskoj školi. Osnovao je i poznati Zadarski omladinski zbor s kojim je gostovao u Zagrebu i Splitu i pobjeđivao na brojnim natjecanjima."

Ka krijuar pozi dhe tregime. Poezitë e para i ka botuar në *Jetën e re* që nga viti 1953 dhe sidomos gjatë viteve 60 të shekullit XX. Ka botuar veprat:

- *"Tregime arbnore"*, 1966,*"Agimet dhe parambramjet e Arbneshit"*, 1969,*"E vërteta"*, 1972,*Vepra letrare, Poezi dhe prozë,* Prishtinë, 2015

Katër kompozime: me titullin e përmbledhur: "Kujtim mbi Arbënesh të Zarës" Dekja e Lerësë, për korin e përzier, "Nina Nana" këngë sollo artistike për sopran e piano, , këngë djepi nga folklori i begatshëm i Zarës, "Romanca", për tenor e piano , të cilën ia kushton Shqiptares së panjohur dhe Lenësës, për korin e përziem. Në këtë përmbledhje është edhe Terceti nga opera e parë e kompozitorëve shqiptarë të Jugosllavisë. (Akil Koci: Kujtim mbi Arbënesh të Zarës, Zëri ..., f. 19.1967, nr,25), *"Vana"* (libret i muzikës dhe operës)

Në krijimtarinë letrare të Shime Deshpalit po ashtu spikaten veçoritë e identietit kombëtar të arbëneshëve. Hasan Mekuli në vështrimin kritik "Agimet dhe parambromjet e Arbëneshit"[9] dhe "Këngëtari i Arbëneshit i të "Pafatmes jetës"- Deshpali, me rastin e vdekjes, shkruan: " Detyra që të jetosh, ... ka të bëjë edhe me një aspekt fare të thjeshtë e real, është detyra të dashurosh , ta kesh prore të ndezur në gji zjarrin e dashurisë për jetën, për njeriun, për vendlindjen, për popullin tënd dhe atdheun, për thesarin shpirtëror të të parëve, për traditat pozitive dhe gjuhën amnore për njerëzoren dhe njerëzimin, si dhe për çdo gjë që të përmbush me krenari dhe të mban gjallë në jetë, edhe kur je në mesin e njerëzve të tjerë me të cilën rron, edhe kur je vetëm, pra në vetminë eventuale, e cila mbase ndryshe ta zbulon fshehtësinë dhe ta tregon rrugën më të përshtatshme për realizimin e kësaj "barre" pa dyshim të rëndë, por të denjë për njeriun.

III.

Vepra Monumentale E Aleksandër Stipqeviçit I Kushtohet Kulturës Tradicionale Shqiptare

Akademik Aleksandër Stipqeviç (1930-2015) në vitin 2011 në Zagreb botoi në gjuhën kroate kryeveprën e vet kushtuar kulturës tradicionale të arbëneshëve të Zarës me titullin "Tradicijska kultura zadarskih Arbanasa". Libri është përkthyer në gjuhën shqipe dhe është botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës në vitin 2012.

Parathënien e kësaj vepre monumentale, që radhitet për kah rëndësia krahas veprës së tij "Ilirët", e shkroi, Akademik Radosllav Katiçiq. Ai vlerëson : "Lexuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se ka marrë në dorë një libër krejtësisht të rrallë...Stipqeviç ndërton me durim hap pas hapi pamjen e kuptueshme dhe të besueshme të kulturës tradicionale të arbëneshëve të Zarës".[10]

Prologu i veprës përfshin qasjen studimore dhe mbledhjen e materiale të kulturës tradicionale. Në Hyrje jep pasqyrën e punimeve kryesore për arbëreshët e Zarës. Shënimet sjellin informacionin me vlerë, referencat funksionale të studimi brilant. Përmbajtja përfshin kaptinat: Jeta dhe doket, Besimet popullore dhe Letërsinë popullore. Literatura e përdorur është jashtëzakonisht e pasur.

Autori ka paraqitur pamjet integrale të kulturës tradicionale shqiptare. Në planin krahasimtar dhe historik, jepen të kuptueshme dhe të krahasueshme me pamjet e kulturës tradicionale shqiptare në të gjitha trojet shqiptare dhe në ngulimet shqiptare, siç janë: Arbëreshët e Italisë, Arbëneshët e Zarës, Arvanitasit e Greqisë dhe diaspora shqiptare. Është studim i kulturës tradicionale të popullit shqiptar, i kulturës materiale dhe shpirtërore gjatë shekujve.

Në Prologun e librit, Stipçeviq paraqet objektin shumë kompleks të studimit dhe mirënjohjen e thellë për të gjithë ata që ia kanë dhënë materialet, rrëfimet dhe ndihmesën e vet për të parë dritën e botimit ky libër kushtuar kulturës tradicionale të popullit shqiptar, të kulturës materiale dhe shpirtërore të tij gjatë shekujve të kaluar.

[9] Hasan Mekuli: „Agimet e parambromjet e Arbëneshit", *Jeta e re,* Prishtinë, 1969, nr.6, f. 1131-1136.

[10] Radosllav Katiqiç, Parathënie në librin e Aleksandar Stipqeviçit: Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2012, f.XII.

Në HYRJE të librit "Mbi Arbëneshët e Zarës" në formë të sintetizuar enciklopedike edhe një herë, për herë të fundit të karrierës shkencore, për lexuesit shkruan për historinë e arbëneshëve që nga shpërngulja e parë dhe deri në ditët e sotme. Në këtë vështrim, me të cilin përkujtojmë edhe ditëlindjen e akademik Aleksandër Stipçeviqit, për të njohur mirë temat e mëdha të historisë ilire-shqiptare, çështjet e identiteti kombëtar gjuhësor dhe kulturor, me të cilat tema është marrë ai gjatë tërë jetës dhe të veprimtarisë së pandërprerë, për të kuptuar më mirë erudicionin, botëkuptimin jetësor të tij, moralin shembullor, shpirtin liridashës dhe iluminist dhe dashurinë e madhe ndaj arbëneshëve.
Në ballë të studimit të vet Stipçeviq sipas kronologjisë dhe rëndësisë që kanë për historinë e Arbëneshit, përmbledh botimet më të rëndësishme, spikat veprimtarinë e shumë autorëve dhe të personaliteteve më të shquara të kësaj oaze shqiptare të Dalmacisë.
Ai shpreh mirënjohjen për ata arbëneshë të hershëm e të sotëm, krijues, interpretues, njerëz të thjeshtë, bujq, amvise, nxënës, studentë, mësues, artistë, shkencëtarë, punonjës publikë etj., për të gjithë autorët e tjerë të cilët janë marrë me studime arbëneshe-shqiptare. Teksti është shkruar mjeshtërisht, është pajisur me ilustrime, portrete, dokumente, faksimile, fotografi, skulptura monumentale dhe me shënime 29 bibliografike. Midis njerëzve të shquar, me ata që e kanë frymëzuar autorin, me të tjerët me të cilët ka bashkëpunuar, me njerëzit e dashur të Arbëneshit, të Shqipërisë dhe botës mbarë, për të paraqitur më mirë pikëpamjet e veta, dëshirat dhe idetë kuptimplota, idealin humanist, dashurinë ndaj atdheut të parë dhe ndaj vendlindjes, patriotizmin, idealet jetësore e shkencore, gjen vetveten dhe zë vendin e merituar në shkencën bashkëkohore.
Personalitetet më të shquara, të cilat sipas një kronologjie kanë zënë vend në vështrimin enciklopedik të Stipçeviqit, janë: Vicko Zmajeviç (Kryepeshkop i Tivarit), Pavao Lluqi Rela, Don Mijo Çurkoviç, Kruno Kërstiq (filozof, filolog, leksikograf), Bonifacije Peroviq françeskan dhe filozof kishtar) Augustin Stipçeviq (shkrimtar), Ivo Perishiq, Josip Gjergja (diplomat), Shime Duka (klerik dhe shkrimtar fetar), Shime Deshpali (kompozitor dhe shkrimtar), Akademik Pavle Deshpali (dirigjent), Maja Deshpali, Valter Deshpali, Mario Kotllar (piktor dhe konservator), Ivan Prenxha (kryepeshkop i Zarës), Niko Stipçeviq, Josip Vlladoviq Rela, (shkrimtar, dramaturg), Pino Gjergja (basketbollist), Renata Petani (sportiste).
Në këtë sintezë enciklopedike radhiten edhe shumë personalitete të tjera arbëneshe: shkencëtarë, artistë, figurativë, muzikantë etj. Për historinë e shpërngulje së arbëneshëve, për jetën, për gjuhën, kulturën tradicionale dhe atë bashkëkohore, për ruajtjen e identiteti kombëtar etj. ai botoi shumë punime dhe vepra shkencore. Midis tyre shquhet "Kulturno-povijesni spomenici u Arbanasima" (Monumentet kulturore historike në Arbënesh), i botuar me rastin e 250-vjetorit të ardhjes së arbëneshëve në Borgo Erizzo, siç është quajtur më parë vendbanimi i ri, i themeluar afër Zarës në vitin 1726. Studimet e këtij autori me famë botërore trajtojnë tema dhe probleme që lidhen me shumë epoka historike dhe me personalitete të botës shqiptare dhe të huaj. Shkrimtarët shqiptarë të traditës, sidomos ata të Rilindjes Kombëtare, nga të cilët shpeshherë është frymëzuar gjatë krijimtarisë, dhe ata bashkëkohës, mësuesit e gjuhës shqipe në Arbënesh etj., janë të përfshirë në mënyrë adekuate në tekstin shkencor, në bibliografinë sistematike ose në referenca të shumta.
Në veprën *Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës* në kapitullin *Mbi Arbëneshët e Zarës* Aleksandër Stipçeviq shkruan: "Për një kohë të gjatë pas vendosjes, arbëneshët nuk kanë pasur kurrfarë lidhjesh me atdheun e vjetër. Vetëm kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i atij XX, arbëneshët e Zarës shfaqin interesim për ngjarjet në Shqipëri, por njëkohësisht disa personalitet të shquara publike dhe politike nga Shqipëria gjithnjë e më tepër u kthehen arbëneshëve dhe e theksojnë vendosjen e lidhjeve ndërmjet atdheut të vjetër dhe banorëve të Arbëneshit". Të veçojmë me këtë rast tekstin për Faik Konicën dhe veprimtarinë e tij në Zarë dhe midis arbëneshëve.

Veprimtaria patriotike dhe kulturore e arbëneshëve me shumë ngjarje është përfshirë në rrjedhat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Shtypi dhe periodiku i asaj kohe ka pasqyruar ngjarjet dhe ka trajtuar problemet aktuale shoqërore, politike dhe kulturore. Mendimi shoqëror dhe politik i Rilindjes ka depërtuar edhe në këtë pjesë të diasporës dhe ka nxitur aktivitete kulturore dhe shoqërore me jehonë të theksuar patriotike. Mësimi i gjuhës shqipe, njohja e historisë dhe e kulturës shqiptare, ka forcuar rezistencën kombëtare dhe ka penguar, aq sa ka qenë e mund-shme, përçarjen kombëtare, dominimin e rrymave të huaja politike dhe asimilimin. Përkthimi dhe botimi në vazhdime i veprës "La colonia albanese di Borgo Erizzo preso Zara", 1883 ("Shcyptaret e Borgo-Erizzos") të Tullio Erberit në revistën "Albania" të Faik Konicës, botimi i poezisë popullore dhe i materialeve të tjera folklorike nga Arbëneshi, vështrimet për gjuhën, historinë dhe për kulturën e shqiptarëve të Zarës, ia kanë bërë të njohur më mirë opinionit më të gjerë shumë aspekte të së kaluarës dhe të realitetit aktual të Arbëneshit. Në revistën "Albania" janë botuar shumë artikuj dhe materiale të tjera lidhur me arbëneshët. Po aty është hapur edhe tribuna e përhershme "Zani préje arbnéshvét". Zara, si qendër e rëndësishme kulturore me traditë shumë të pasur, ka pasur ndikim të gjithanshëm në emancipimin kulturor edhe te arbëneshët. Aty zhvillonin aktivitete të shumta grupet dilitante artistike, të cilat shfaqnin pjesë teatrore dhe programe të ndryshme artistike muzikore. Leximorja e Arbëneshit po ashtu tubonte të rinjtë për të organizuar aktivitete kulturore dhe letrare. Në seksionet e dramës bënin pjesë edhe shumë 31 arbëneshë të moshuar dhe të rinj. Në këtë rrjedhë të jetës kulturore, me specifika edhe të jetës arbëneshe, janë afirmuar edhe shoqëritë kulturore dhe artistike. Me veprimtarinë e saj është shquar sidomos Shoqëria "Arbanasi" ("Arbëneshi").

Të veçojmë me këtë rast tekstin për Faik Konicën dhe veprimtarinë e tij në Zarë dhe midis arbëneshëve. Veprimtaria e tij në koloninë e arbëneshe më parë nuk është ndriçuar sa duhet. Posaçërisht i rëndësishëm është dorëshkrimi në gjuhën frënge "*Parashtresë mbi lëvizjen Kombëtare Shqiptare*", i gjetur në Arkivin e Vjenës më 28 maj 1976. Teksti i shkruar në vitin 1899 në Bruksel, ka 84 faqe dhe i është dërguar Ministrisë së Jashtme të Austrisë. Shkrimi ndahet në pesë pjesë dhe përfshin periudhat historike të Lëvizjes Shqiptare: pjesa e parë deri në vitin 1877, ndërsa tri të tjerat deri në vitin 1899.

Në pjesën e fundit përfshihen emrat e personaliteteve të shquara të Lëvizjes Kombëtare. Ai disa herë ka qëndruar në Zarë dhe në Arbënesh. Stipqeviq shkruan se Konica katër herë e ka vizituar Arbëneshin. „Në atë kohë arriti në Arbënesh një "filolog" - siç e quante policia e fshehtë austriake. Kjo polici sekrete e gjithëdijshme kishte marrë vesh se nga ai "filolog" kishte rrjedhur ideja që në Arbënesh të fillonte botimi i gazetës në gjuhën shqipe, e cila do t u shërbente si burim i informatave jo vetëm arbëneshëve të Zarës, por edhe të gjithë shqiptarëve në gjithë Shqipërinë, pastaj atyre në Itali dhe në vendet e tjera ku jetonin ata. Gazeta do të kishte titullin "Zani i Šćyptarit", kurse nismëtart e kësaj ndërmarrjeje ishin: Mijo Çurkoviqi, Petar Marushiçi, Kërsto Stipçeviqi, dhe Luçi Pavao Rela."[11]

Formimi i shoqërisë kombëtare në Kuvendin e mbajtur më 8 prill 1903 në Arbënesh ka qenë ngjarje e rëndësishme për shqiptarët e këtij lokaliteti. Në pikën e parë të dëshirave të shqiptarëve është përfshirë ky tekst:

"I. Jemi é levdohémi ce jémi Shciptare nga ghaku é nga zemera. Si Shciptare, nohim per déture te shentmé te duhémi te ghithe sa jemi 32 Shciptare, te jémi te bashkuem é te japim, mish é shpirt per te shellbuar ghakun t'on, - ghuhen t'one".

II. *Ghuha shcipé eshte (hezinéja) jone, sé ghuha eshte më i pari shenim ci rrefen kombesine. Po zghedhim ñe keshill shtate krénesh, të tsileve Mbledhja u jép plot fuci te perpicén me sa u mundet ce Cévéria Austriané te kllase ne shkollat t'ona mésimin é ghuhes shqipe.*

[11] Aleksandar Stpčević, *Tradicijka kultura zadarskih Arbanasa*, "Ibis", Zagreb, 2011. Str.10.

III. *Na deri tash nuk jenna marre vesht aspak se si me muejt me u nimue vllazneve t' one n' Shcypni. Jo me u nimue me pushk e me shpate, por me kulture. Per si kena ne me u nimue vllazneve me kulture, masi as na vete kulture nuk kemi? Ktu marr vesht kulturen shcype.Vllazen! Ka ardhe koha m' u - chue preje ghumit."*[12]
Lidhur me zhvillimin e arsimit në Arbënesh, shkruan: "Do të duhej të krijohej një kolegj, qoftë në Zarë, qoftë në
Sarajevë, qoftë në vetë Shqipërinë (në Orosh, për shembull) me qëllim të dyfishtë, për të dhënë mësim substancial për profesorët e ardhshëm shqiptarë, dhe të shkohet atje për t'u dhënë, - simbas kolegjeve shqiptare në Itali - një mësim komplet, të rinjve të familjeve pak a shumë me ndikim (4.XVII)."
Pasqyrën më të plotë të studimeve për arbëneshët, dhe sidomos për gjuhën e arbëneshëve të Zarës, e gjejmë në studimin monografik "*Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës*" të akademik Idriz Ajetit. Më 1987 është botuar "*Fjalori i të folmes së arbëneshëve të Zarës*". Autorë të tjerë kanë studiuar aspekte të ndryshme të historisë, të arsimit dhe të kulturës së kësaj bashkësie etnike shqiptare. Akademik Rexhep Qosja ka botuar studimin për krijimtarinë letrare të Josip Relës "Josip Vlladoviç-Rela (1895-1966)".
Literatura jashtëzakonisht e pasur, e shfrytëzuar me akribi shkencore, metodologjia e punës kërkimore 33shkencore, veçoritë gjuhësore dhe stilistike, përdorimi i terminologjisë adekuate, hartimi i bibliografisë, pasqyrimi i burime arkivore dhe tekstore dhe sidomos dendësia e të shprehurit dhe ndërtimi kompozicional, mahnitin çdo studiues dhe e bindin se punimi shkencor i Stipçeviqit, siç është edhe kjo sintezë enciklopedike kushtuar arbëneshëve të Zarës, është pikë referuese në fushën e shkencave albanologjike.
Literatura e përdorur dhe shënimet përkatëse, 40 njësi, për studimin *Mbi arbëneshët e Zarës* të Aleksandër Stipçeviqit përfshihen në faqet 36-41 të librit.

Referencat

[1] Ajeti, Idriz. Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra. Sarajevo, 1961.
[2] Ajeti, Idriz. Vepra I: Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 1997.
[3] Bej Konitza, Faik. "Shoceria kombetaré é Borgo Eritsos." Albania, Bruksel, 1901, nr. 4, f. 67.
[4] Çabej, Eqrem. "Ngulimet shqiptare jashtë atdheut." Ylli, Tiranë, 1967, nr. 1, f. 22–24.
[5] Deshpali, Shime. Vepra letrare. Prishtinë: LSHK, 2015.
[6] Katičić, Radosllav. "Parathënie." Në: Aleksandar Stipčević, Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës. Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2012, f. XII.
[7] Krstić, Kruno. Rječnik govora zadarskih Arbanasa. Zarë: Bashkësia Lokale e Arbëneshëve, 1987.
[8] Mekuli, Hasan. "Agimet e parambromjet e Arbëneshit." Jeta e re, Prishtinë, 1969, nr. 6, f. 1131–1136.
[9] Qosja, Rexhep. Shkrimtarë dhe periudha. Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1975, f. 189–232.
[10] Rela, Josip. "Arbëneshët e Zarës." Në: Vepra II. Prishtinë: Rilindja, 1971, f. 265–266.
[11] Shema, Isak. Arbëneshët e Zarës – Shqiptarët e Zarës. Prishtinë, 2004.
[12] Shema, Isak. Josip V. Rela – Jeta dhe krijimtaria letrare. Prishtinë, 2016.
[13] Shema, Isak. Mësimi i shqipes në Arbënesh të Zarës. Prishtinë, 2017.
[14] Shema, Isak. Punime dhe vepra të botuara për Arbëneshët e Zarës (Bibliografi).
[15] Shema, Isak. Studije albanske književnosti. Prishtinë: Dituria, 2015.
[16] Akademik Aleksandër Stipçeviq. Prishtinë: Kolegji Iliria, 2017.
[17] Stipčević, Aleksandar. Tradicijska kultura zadarskih Arbanasa. Zagreb: Ibis, 2011.
[18] Stipçeviç, Aleksandër. Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës. Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2012.

[12] Fk Bej Konitza, "Shoceria kombetaré é Borgo Eritsos", "Albania", Bruxelles, 1901, nr.4, f.67.